

## **PLANI LOKAL PËR VEPRIM I KOMUNËS SË KËRÇOVËS DHE KOMUNITETIT ROM 2023-2026**

### **DHE**

### **Plani për veprim për uljen e pasojave të KOVID-19 te komuniteti rom në periudhën post KOVID-19 në nivel lokal 2023-2024**

#### **Të dhëna të përgjithshme për gjendjen e komunitetit Rom në Maqedoninë e Veriut**

Në fushën e shëndetësisë, Romët përballen me probleme të shumta. Përqindja e lartë e sëmundjeve kronike afatgjatë kontribuojnë në vdekjen e përshpejtuar dhe të parakohshme të kësaj popullsie të qytetarëve.

Analizat tregojnë se mesatarisht Romët jetojnë 10 vjet më pak se popullsia e përgjithshme. Jetëgjatësia e shkurtër e Romëve është dokumentuar në shumë raporte, me çrast rezultatet e Entit shtetëror për statistika tregojnë se 7% e komunitetit rom vdesin në moshën 25-44 vjeç, ndërsa 37% vdesin në moshën 45-64 vjeç. Rreth 49% vdesin në moshë ndërmjet 65-84 vjeç, me vetëm 7% që jetojnë deri në moshën 85 vjeç.

Nëse krahasojmë me pensionin e pleqërisë, vetëm 45% e Romëve mund të presin pension të pleqërisë, ndërsa te Jo-Romët, përqindja është mesatarisht 75%.<sup>1</sup>

Një numër i konsiderueshëm i Romëve kanë probleme me qasjen në shërbimet shëndetësore, veçanërisht personat që nuk janë të identifikuar në sistem, personat që nuk kanë dokumente personale dhe nuk kanë sigurim shëndetësor.

---

<sup>1</sup>Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030 / [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

Informacionet e fundit zyrtare të Ministrisë së punës dhe politikës sociale flasin për një numër prej rreth 700 personash që nuk kanë sigurim shëndetësor për shkak të mungesës së dokumentacionit personal, por sipas organizatave joqeveritare ky numër është shumë më i lartë.

Faktorët e mëposhtëm ndikojnë në qasjen e Romëve në shërbimet shëndetësore:

Distanca deri në spitalin më të afërt për 27% të Romëve është dy kilometra, dhe shtëpitë e rreth 12% të familjeve rome nuk kanë qasje në një rrugë të asfaltuar.<sup>2</sup>

Qasja në ujë të pijshëm të pastër dhe mirëmbajtja e higjienës personale, rreth 10% e ekonomive familjare rome në vend nuk kanë ujë të pijshëm brenda shtëpive të tyre, ndërsa 18% e ekonomive familjare nuk kanë qasje në sistemin e kanalizimit<sup>3</sup>

Kushtet e këqija në të cilat jetojnë dhe vendbanimet rome kryesisht janë afër deponive të egra

Mungesa e mjeteve financiare kontribuoi në pamundësinë për të siguruar produkte të mjaftueshme për higjienë personale.

Informimi i pamjaftueshëm për vaksinat dhe procesin e vaksinimit.

Sipas hulumtimit të UNDP-së dhe Bankës Botërore, përqindja e Romëve të përfshirë në papunësi joformale është ulur në periudhën e viteve 2011-2017 me 26 pikë përqindje, duke arritur në 38%.

Sipas të dhënave nga Programi i reviduar për reforma në punësimin dhe politikën sociale, mesatarisht 25% e popullsisë punon në mënyrë joformale. Forma më e zakonshme e punësimit joformal te meshkujt Rom është në tregti, shërbime taksi, si dhe në ndërtimtari dhe bujqësi, ndërsa te femrat Rome forma më e zakonshme e punësimit është në tregti dhe shërbime higjienike. Shumë familje rome mbështeten në punën sezonale në stinën e verës gjatë sezonit të korrjes. Rreth 48% e familjeve rome janë përdoures të ndihmës sociale<sup>4</sup>.

Sipas të dhënave të hartëzimit social nga viti 2018, shkalla e punësimit të Romëve është 23%, pothuajse dyfishi i mesatares nacionale, ndërsa shkalla e papunësisë së romëve është në nivel rekord prej 67%. Te gratë Rome, shkalla e punësimit është 8%.<sup>5</sup>

Për uljen e papunësisë, në kuadër të planit operativ të punësimit, parashikohen masa për punëdhënësit për t'i inkurajuar ata të punësojnë Romët ose të zhvillojnë bizneset e tyre, si dhe masa për rritjen e aftësive të personave të papunë. Mesatarisht, rreth 3-4% e Romëve kanë qenë përdorues të masave

---

<sup>2</sup>Sfidat për Romët gjatë krizës së shkaktuar nga KOVID-19, Raport i Institutit për politika evropiane Shkup, maj 2020

<sup>3</sup>Sfidat për Romët gjatë krizës së shkaktuar nga KOVID-19, Raport i Institutit për politika evropiane Shkup, maj 2020

<sup>4</sup>Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030 / [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

<sup>5</sup>Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030 / [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

aktive të punësimit në vitet e fundit dhe megjithëse numri absolut i përduesve Rom po rritet, pjesa relative e numrit të përgjithshëm të përdoruesve të mbuluar nga masat aktive të punësimit mbetet e pandryshuar<sup>6</sup>

Projeksionet e raportit të UNICEF-it tregojnë se në Maqedoninë e Veriut përqindja e fëmijëve që jetojnë në ekonomitë familjare, standardi i jetës së të cilëve është dukshëm nën mesataren nacionale është rritur nga 27.8% para pandemisë në 32.4% pas pandemisë. Kjo i vendos 19.000 fëmijë në Maqedoninë e Veriut nën kufirin e varfërisë relative, që është më i lartë krahasuar me vlerësimin e korrikut të vitit 2020 për 16.000 fëmijë.<sup>7</sup>

Problem real sistemor është edhe ajo se shkollat nuk kanë një sistem për mbledhjen e të dhënave për statusin social-ekonomik të fëmijëve Rom, gjë që do të mundësonte vlerësimin e nevojës për ndihmë gjatë qasjes në arsimin e duhur.

90% e lagjeve ku jetojnë Romët në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë joformale dhe nuk janë të mbuluara nga Plani detal urbanistik. Kjo sjell një sërë problemesh komplekse si: kushte joadekuate të jetesës, infrastrukturë të dobët, mungesë të qasjes në kanalizimin fekal dhe atmosferik, mungesa e qasjes në ujë dhe energji elektrike. Familjet Rome zakonisht jetojnë në shtëpi individuale, me një numër më të madh anëtarësh të familjes. Gjatë pandemisë, familjet e tilla kishin probleme serioze me hapësirën për izolim dhe ruajtjen e distancës sociale kur kishin një anëtar të familjes të sëmurë, mbajtjen e higjienës dhe mbrojtjes të duhur.

Sipas Raportit rajonal për Romët nga viti 2017 të realizuar nga UNDP për vendet e Ballkanit Perëndimor, gjendja në aspektin e infrastrukturës në Republikën e Maqedonisë së Veriut është si vijon:

- 10% e Romëve nuk kanë qasje në ujë
- 16% e Romëve nuk kanë qasje në kanalizimin publik
- 26% e Romëve nuk kanë tualete në shtëpi
- 7% e Romëve nuk kanë qasje në energji elektrike<sup>8</sup>

Përveç asaj, si problem serioz është theksuar problemi i legalizimit të shtëpive të ndërtuara pa leje te komuniteti rom, i cili në afat të gjatë krijon pasoja të rënda për jetën e familjeve rome.

---

<sup>6</sup>Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030 / [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

<sup>7</sup><https://www.unicef.org/northmacedonia/press-releases/not-all-children-are-accessing-vital-services-due-covid-19-pandemic-putting-them>

<sup>8</sup>Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030 / [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

Sipas analizave të mëparshme dhe të dhënave nga hartëzimi social, rreth 28% e romëve nuk kanë legalizuar vendbanimet e tyre për shkak të mungesës së një plani urbanistik në komunë për ato vendbanime ose për shkak të pamundësisë për të mbuluar shpenzimet financiare. Gjithashtu, qytetarët që kanë paraqitur kërkesa për legalizimin e objekteve të tyre kanë më shumë se 5 vite që presin përgjigje nga institucionet kompetente lidhur me statusin e kërkesës së tyre.

Rrjedhimisht, kushtet e këqija në fushën e banimit ndikojnë në qasjen në arsim, shërbimet shëndetësore, punësim dhe të drejta të tjera themelore të njeriut, të cilat duhet të jenë të disponueshme për çdo individ. Mungesa e një qasje të tillë e bën komunitetin të marginalizuar, të varfër dhe të paarsimuar, të kufizuar në lagjet e veta (komunitete të segreguara).<sup>9</sup>

3% e familjeve rome në Maqedoninë e Veriut nuk kanë qasje në energji elektrike, ndërsa 38% nuk kanë qasje në internet dhe 51% nuk kanë kompjuter.<sup>10</sup>

## **Hyrje, profili dhe identifikimi i komunitetit rom që jeton në territorin e Komunës së Kërçovës**

Veprimi në nivel lokal është i një rëndësie vendimtare për zbatimin efikas të politikave dhe programeve për përfshirjen e Romëve. Ky është niveli ku shkëputja është më e dukshme dhe ku nevojiten hapa praktike për përfshirje. Sfida kryesore për zbatimin efektiv të politikave të përfshirjes së Romëve në nivel evropian dhe nacional është dallimi i madh në mirëkuptim, kapacitete dhe përkushtim politik në nivel komunal.

Për përfshirjen e suksesshme të politikave të gjithëpërfshirjes së romëve në agjendën dhe buxhetet nacionale, është me rëndësi të madhe që administrata dhe institucionet lokale të rrisin angazhimin dhe përpjekjen e tyre dhe të zhvillojnë më tej kapacitetet e tyre.

Megjithatë, praktika e qeverisjes së mirë dhe demokracisë lokale do të varet gjithashtu nga investimi në kapacitetin e komuniteteve rome të rrezikuara për të qenë pjesëmarrës aktiv dhe partner të barabartë në proces, në vend të pranuesve pasiv dhe qëllim i ndërhyrjeve paternaliste që mund të vërtetojnë varësinë dhe përjashtimin e tyre.

---

<sup>9</sup>Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030 / [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

<sup>10</sup>Sfidat për Romët gjatë krizës së shkaktuar nga COVID-19, Raport i Institutit për politika evropiane Shkup, maj 2020

Komuniteti etnik rom në Komunën e Kërçovës është shumë i integruar dhe nuk jeton në geto. Ai është shumë i ndryshëm nga pjesa tjetër e komunitetit etnik rom në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe si i tillë ka specifikat dhe nevojat e veta.

Rajoni i Kërçovës ndodhet në pjesën perëndimore të Republikës së Maqedonisë, i vendosur në Luginën e Kërçovës, që është një tërësi natyrore me formë të qartë, e rrethuar nga të gjitha anët me male të larta. I përket pellgut të sipërm ujëmbledhës të lumit Treska, në anën veriore prek deri në qafën e Strazhës, në anën perëndimore ngrihet mali Bistra, në anën jugore shtrihet përgjatë luginës së lumit Treska deri në Malin e Ilinës dhe në anën lindore prek pjesën veriore të Poreçes. Një lum më i madh përveç lumit Treska është lumi i Zajazit i cili rrjedh në qytetin ndërmjet Kalasë së Kitinës dhe lagjes Biçinci. Përgjatë qytetit rrjedh edhe një lum më i vogël i njohur si Sushica, i cili, siç thotë edhe vetë emri, është periodik, me një rrjedhje jo të përhershme gjatë periudhës së verës. Është e sigurt se një nga monumentet natyrore të qytetit të Kërçovës është lumi Treska, i cili është degë e majtë më e madhe e Vardarit. Mbi Kërçovë ngrihet kodra e bukur e Krushinës, e pasur me natyrë, ajër të pastër dhe gjelbërim, e cila është një vend i jashtëzakonshëm për rekreacion. Kalaja e Kërçovës është një nga monumentet e qytetit, dhe jo shumë larg Kërçovës ndodhet Manastiri i famshëm i Kërçovës ose Manastiri i Virgjëreshës Mari.

Me ndarjen e re territoriale të vitit 1996, rajoni i Kërçovës ndahet në 5 komuna: Komuna e Kërçovës, Komuna e Drugovës, Komuna e Zajazit, Komuna e Oslomejit dhe Komuna e Vraneshticës.

#### Sipërfaqja

- E përgjithshme 838 km<sup>2</sup> (324 m<sup>2</sup>)

Struktura demografike e popullsisë në Komunën e Kërçovës është shumë e larmishme dhe interesante. Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2002, Komuna e Kërçovës ka 30.138 banorë, përkatësisht ka një rritje të popullsisë prej 9,42% në krahasim me regjistrimin paraprak në vitin 1994. Dendësia e popullsisë është 615,1 banorë për 1 km<sup>2</sup>, 60% e popullsisë është autoktone, dhe nga banorët e shpëngulur në vendbanimin e zakonshëm, 6,5% janë nga një vend tjetër në të njëjtën komunë (migrimi fshat-qytet), 86,9% vijnë nga një komunë tjetër dhe 6,6% janë të shpëngulur nga një shtet tjetër. Në periudhën nga viti 1994 deri në vitin 2002, kanë ndodhur ndryshime të caktuara në raportin numerik të popullsisë sipas përkatësisë nacionale. Mirëpo, edhe në njërin vit të regjistrimit edhe në tjetrin mbizotëron numri i popullsisë maqedonase dhe është rritur edhe numri i popullsisë shqiptare. Numri i bashkësive tjera etnike është i ngjashëm në të dy vitet e regjistrimit.

Në vitin 2002, popullsia maqedonase numëronte 16,140 banorë, që paraqet 53,6% të popullsisë së përgjithshme në komunë. Në të njëjtin vit, popullsia shqiptare numëronte 9202 banorë ose 30,5% e popullsisë së përgjithshme. Nacionalitetet tjera janë më pak të përfaqësuara. Turqit numërojnë 2430 banorë ose 8,1%, e popullsisë Rome dhe përfaqësohen me 5,4%, respektivisht një numër prej 1630 banorësh, 76 persona anë deklaruar si Vllehë, respektivisht ata

janë të përfaqësuar me 0,3%, numri i Serbëve në komunë është 86 që përfaqëson 0,3%, 7 persona janë deklaruar si Boshnjakë dhe pjesa tjetër e popullsisë përfshin 567 banorë ose 2,1%.

Me kalimin e viteve, ky ishte numri i përgjithshëm i popullsisë dhe përkatësisë etnike të popullsisë në qytetin e Kërçovës:

*Të dhënat nga Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, 2002:*

Popullsia e përgjithshme	Gra	Burra	I arsimuar	Analfabet	Ekonomitë familjare	Banesa	Numri mesatar i anëtarëve në ekonominë familjare
<b>67053</b>	<b>33015</b>	<b>34038</b>	<b>54103</b>	<b>2749</b>	<b>18286</b>	<b>22422</b>	<b>3.67</b>

Rezultatet e regjistrimit të popullsisë në vitin 2021 në Komunën e Kërçovës, numri i Romëve është:

Numri i Romëve	2002	2022 në %	2021	2021 në %
Kërçovë	1631	5,4%	2063	3,6%

Bashkësia etnike Rome është e përqendruar në disa vendbanime: Kalendericë (Dushan Joveski, Cvetko Jakovleski, Mehmed Mehmedi, Ilija Cvetkoski – Sveshtarot, Engelsova), Rashtani - (Çetat partizane, f.Osoj, Meksiko, Rruga e Vllehëve, Selanik, 4 - Brigada shqiptare), Kulla e bardhë – (Pashino, Skopska, Marshall Tito, Kraguevaçka, Strushka), Mëhalla – (Prilepska) e të tjera.

Sipas evidencës në Agjencinë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Qendra Kërçovë, deri më datë 31.06.2022 janë regjistruar gjithsej 3579 aplikantë aktiv, prej të cilëve 1793 janë burra dhe 1786 janë gra. Prej tyre 309 persona janë Rom të papunë.

Në vitin shkollor 2021/2022, në SHF Sande Sterjoski – Kërçovë – arsim fillor janë të regjistruar 400 nxënës Rom.

Në vitin akademik 2021/2022 në SHMK “Mirko Mileski” – Kërçovë janë regjistruar 72 nxënës romë, prej të cilëve 42 janë femra dhe 30 meshkuj, të cilët vijnë nga Gjimnazin e përgjithshëm dhe Arsimin e mesëm profesional.

Në vitin akademik 2021/2022 deri më tani janë regjistruar 4 studentë Rom, nga të cilët dy studentë janë në Fakultetin e Mjekësisë, një student në Fakultetin Pedagogjik dhe një në Fakultetin e Doganës.

Nga numri i përgjithshëm i popullsisë Rome në Komunën e Kërçovës si përfaqësim në institucionet lokale, njësitë rajonale dhe qendrat janë këto numra:

- Qendra e Kulturës "Koço Racin" - Kërçovë (1 i punësuar) - gjinia - burr
- Qendra për menaxhim me kriza - Kërçovë (2 të punësuar) - gjinia - 1 burrë dhe 1 grua
- Qendra për punë sociale (përmes Programit KIR - Informator) - Kërçovë (1 punëtor) - gjinia - burr
- Qendra e shëndetit - Kërçovë (Ndërmjetësues shëndetësor - Ministria e Shëndetësisë (2 të punësuar përmes programeve) - gjinia - gra
- Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim - njësia rajonale Kërçovë (1 i punësuar) - gjinia - burr
- Pyjet e Maqedonisë - Kërçovë (1 i punësuar) - gjinia - burr
- Ndërmarrje publike komunale - punëtorë sezonal - Kërçovë (17 të punësuar) - gjinia - burr
- MPB Sektori për punë të brendshme - Kërçovë (1 i punësuar) - gjinia - burr
- Ministria e Drejtësisë - Njësia rajonale Kërçovë - Ndihmë juridike pa pagesë - (1 i punësuar) gjinia - burr
- Qendra e shëndetit - Kërçovë - Infermiere (1 i punësuar) gjinia - grua
- Kompanitë dhe ndërmarrjet (Xhojson Kontroli - 156 të punësuar) gjinia - burra 66 dhe gra 90
- Ministria e mbrojtjes - ARM - Kazerma Kërçovë - (2 të punësuar) gjinia - burra
- SHF "Sande Sterjoski Kërçovë, - Arsimitar i shkollës fillore (1 i punësuar) gjinia burr.
- Ministria për sistem politik dhe marrëdhënie me komunitetet - Shkup (1 i punësuar) gjinia - burr
- SHA ELEM - REK OSLOMEJ - dega Kërçovë - (11 të punësuar) gjinia - burra

Dokumentet që janë përgatitur (dhe miratuar çdo vit nga Këshilli i Komunës së Kërçovës) dhe të cilat në mënyrë indirekte synojnë komunitetin Rom nga Komuna e Kërçovës janë:

- Program për kremtimin e manifestimeve kulturore
- Programi për rregullimin e tokës ndërtimore;
- Programi për ndërtimin, rindërtimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve dhe rrugëve lokale në Komunën e Kërçovës;
- Programi për punë publike;
- Programi për parandalim, mbrojtje dhe shpëtim;
- Programi për mbrojtje sociale i Komunës së Kërçovës;
- Programi për banim social të romëve në Kërçovë;
- Programi për githëpërfshirjen ekonomike të të rinjve romë në Komunën e Kërçovës;

- Pilotimi i programit për mbështetje të përgjegjshme sociale - energji elektrike për EVN dhe Shërbimet komunale;
- Programi për mbrojtja sociale dhe mbrojtje të fëmijëve;
- Programi për mbështetje sociale, ndihmë e njëhershme për të përmbyturit nga valët e lumenjve gjatë fatkeqësive natyrore;
- Strategjia për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

### Të dhëna të rëndësishme për Komunën:

Numri i përgjithshëm i banorëve Rom në komunë	Lagjet ku jetojnë Romët	Të punësuarit Rom sipas institucioneve	Numri i fëmijëve Rom të përfshirë në kopshte për vitin e fundit shkollor 2021/2022	Numri i fëmijëve Rom të regjistruar në shkollën fillore në vitin e fundit shkollor 2021/2022	Numri i fëmijëve Rom të regjistruar në shkollat e mesme në vitin e fundit shkollor 2021/2022
1631	Lagjet rome në rrugët "Marshal Tito, Skopska, Kulla e Bardhë, Pashinë - - Strushka, Kraguevaçka), Rashtani - (Çetat partizane, Osoj, Meksiko) Rruga e Vllehëve, Prilepska. Më pak të shpërndarë janë në rrugët: Dushan Joveski, Engelseva, Cvetko Jakovleski, Mehmed Mehmedi, 11 Shtatori, Ljubica Bogeska, Brigada e 4-të Shqiptare, Po ashtu janë 5 familje që janë të vendosura në një ndërtesë sociale dhe 4 familje në një ndërtesë të vjetër të policisë, si dhe disa familje në qendër të qytetit.	Qendra e Kulturës "Koço Racin" - Kërçovë (1 i punësuar) - gjinia - burr Qendra për menaxhim me kriza - Kërçovë (2 të punësuar) - gjinia - 1 burr dhe 1 grua Qendra për punë sociale (përmes Programit KIR - Informator) - Kërçovë (1 punëtor) - gjinia - burr Qendra e shëndetit - Kërçovë (Ndërmjetësues shëndetësor - Ministria e Shëndetësisë 2 të punësuar përmes programeve) - gjinia - gra Drejtorja për mbrojtje dhe shpëtim - njësia rajonale Kërçovë (1 i punësuar) - gjinia - burr Pyjet e Maqedonisë - Kërçovë (1 i punësuar) -	Gjithsej 7	Gjithsej 400 nxënës	Gjithsej 72



		<p>gjinia - burr  Ndërmarrje publike  komunale - punëtorë  sezonal - Kërçovë (17 të  punësuar) - gjinia - burr  MPB Sektori për punë të  brendshme - Kërçovë (1 i  punësuar) - gjinia – burr  Ministria e Drejtësisë -  Njësia rajonale Kërçovë -  Ndihmë juridike pa pagesë -  (1 i punësuar) gjinia - burr  Qendra e shëndetit -  Kërçovë - Infermiere (1 i  punësuar) gjinia - grua  kompanitë dhe ndërmarrjet  (Xhojson Kontrolls – 156 të  punësuar) gjinia - burra 66  dhe gra 90  Ministria e Mbrojtjes - ARM  - Kazerma Kërçovë - (2 të  punësuar) gjinia - Burra  SHF.Sande Sterjoski  Kërçovë, - Mësimdhënës i  shkollës fillore *(1 i  punësuar) gjinia burr  Ministria për sistem politik  dhe marrëdhënie me  komunitetet - Shkup (1 i  punësuar) gjinia - burr  SHA ELEM - REK OSLOMEJ -  dega Kërçovë - (11 të  punësuar) gjinia - burra</p>						
			Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
			4	3	/	/	30	72

	Numri i përgjithshëm i anëtarëve			Numri i përgjithshëm i të rinjve
		Burra	Gra	
Anëtarët e Grupit për veprim në komunitet	18	11	7	4
Anëtarët e Grupit institucional të punës	12	7	5	3
Anëtarët e Grupit komunal të punës	9	7	2	6

## **Qëllimet dhe rezultatet e planifikuara të planit lokal për veprim (PLV)**

### **Urbanistikë, banim, shërbime themelore**

Nr.	Masa / Aktiviteti	Rezultatet e pritura	Lidhja me dokumente të tjera strategjike	Institucionet kompetente	Afati kohor (nga-në)	Buxheti		Monitorimi/Vlerësimi	
						Vlerësimi buxhetor në denarë (MKD)	Burimi	Indikatori	Programi buxhetor

1	Infrastruktura - Përfundimi i asfaltimit të rrugëve ku banojnë romët në rr. Rruga i Vllehëve, Meksiko, Çetat Partizane	Përmirësimi i kushteve të jetesës së familjeve rome nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të programeve për rigjenerimin e integruar urban dhe çrrënjosjen e kushteve të dëmshme të jetesës	Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030	Komuna e Kërçovës	Janar 2023 – Qershor 2024		Buxheti i Komunës së Kërçovës	Projektet e realizuara	Raporti i Komunës së Kërçovës
	Rrjeti i ri i ujësjellësit dhe kanalizimeve në rr. Meksiko	Sigurimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve dhe përmirësimi i shëndetit dhe higjienës së përgjithshme të popullsisë	Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030	Komuna e Kërçovës	Janar 2023 – Qershor 2024		Buxheti i Komunës së Kërçovës	Rrjeti i vendosur	Raporti i Komunës së Kërçovës
3	Ndriçimi publik i rrugëve	Përmirësimi i kushteve të jetesës së romëve në selbi nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të programeve për rigjenerimin e integruar urban	Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030	Komuna e Kërçovës	Janar 2023 – Qershor 2024		Buxheti i Komunës së Kërçovës	Rrugët e ndriçuara	Raporti i Komunës së Kërçovës

4	Vendosja e pengesave për ndalimin e shpejtësisë në rrugë në rr. Dushan Joveski, Çetat partizane, Pashino, Rruga e Vllehëve e të tjerë.	Përmirësimi i kushteve të jetesës së romëve në selbi nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të programeve për rigjenerimin e integruar urban	Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030	Komuna e Kërçovës	Janar 2023 – Qershor 2024	/	Buxheti i Komunës së Kërçovës	Numri i projekteve të përfunduara dhe në cilat rrugë	Raporti i Komunës së Kërçovës
5	Veprimtaritë komunale – Pastrimi i deponisë – Pastërtia publike	Përmirësimi i kushteve të jetesës së romëve në selbi nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të programeve për rigjenerimin e integruar urban	Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030	NKP Komuna e Kërçovës	Janar 2023 – Qershor 2024	/	Programi dhe buxheti ekzistues i NKP	Projektet e realizuara	Raporti i Komunës së Kërçovës

## Lufta kundër diskriminimit të Romëve

Nr.	Masa / Aktiviteti	Rezultatet e pritura	Lidhja me dokumente të tjera strategjike	Institucionet kompetente	Afati kohor (nga-në)	Buxheti		Monitorimi/Vlerësimi	
						Vlerësimi buxhetor në denarë (MKD)	Burimi	Indikatori	Burimi
1	Pjesëmarrja në një fushatë nacionale për të dënuar praktikën e ndalimit të qasjes të Romëve në objektet/lokalet (pishinë, restorant, bar kafe, etj.)	Përmirësimi i kushteve të jetës dhe lëvizja e lirë e Romëve në të gjitha objektet/lokalet publike	Strategjia Nacionale për Romët 2022-2030	Komuna e Kërçovës	Shtator 2022 – Qershor 2023 Shtator 2023 – Qershor 2024		Në kuadër të programit ekzistues të Komunës  Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut	Liria e lëvizjes së Romëve në të gjitha objektet/lokalet publike	Raportet e Komunës së Kërçovës (periodike)  Raportet nga aktivitetet e realizuara

## Arsimi

Nr.	Masa / Aktiviteti	Rezultatet e pritura	Lidhja me dokumente të tjera strategjike	Institucionet kompetente	Afati kohor (nga-në)	Buxheti		Monitorimi/Vlerësimi	
						Vlerësimi buxhetor në denarë (MKD)	Burimi	Indikatori	Programi buxhetor

1	Arsimi - (përmirësimi i arsimit të romëve, dhënia e bursave për Romët nga Komuna e Kërçovës, dhënia e laptopëve për nxënësit që nuk janë në gjendje të vijnë në mësimin dhe përmirësojnë mësimin - Përmirësimi i arsimit të të rriturve përmes programeve të shkurtuara.	Përmirësimi dhe përvetësimi i arsimit të romëve nëpërmjet masave dhe programeve aktive	Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030	Komuna e Kërçovës	Janar 2023 – Qershor 2024	/	Buxheti i Komunës së Kërçovës/Donacion	Projektet e realizuara	Raporti i Komunës së Kërçovës
2	Transport publik të shkollës për fëmijët e moshës parashkollore dhe për nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm	Përmirësimi i rregullsisë dhe frekuentimit në institucionet arsimore përmes transportit publik të fituar si mjet për fëmijët që janë nga familje me rrezik social dhe jetojnë më shumë se 2 km larg	Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030	Komuna e Kërçovës dhe shkollat lokale	Janar 2023 – Qershor 2024	/	Buxheti i Komunës së Kërçovës	Numri i fëmijëve për të cilët sigurohet transporti / % e përfaqësimit gjinor	Raporti i Komunës dhe shkollat
3	Rritja e numrit të fëmijëve në institucionin parashkollor për 5%	Rritja e numrit të fëmijëve në institucionin parashkollor të përfshirë në projektin për gjithëpërfshirjen e fëmijëve Rom	Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030	Komuna e Kërçovës dhe kopshtet lokale	Janar 2023 – Qershor 2024	/	Në kuadër të programit dhe buxhetit ekzistues	Numri i fëmijëve të përfshirë / % e përfaqësimit gjinor	Raporti i Komunës dhe shkollat
4	Trajnim për mesimdhënës (fillor dhe të mesëm) dhe kujdestarë	Të mbahen trajnime për mesimdhënësit dhe kujdestarët	Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030	Komuna e Kërçovës dhe shkollat lokale	Janar 2023 – Qershor 2024	/	Në kuadër të bashkëpunimit me një projekt ndërkombëtar	Numri i trajnimeve të realizuara dhe numri i mësuesve të përfshirë	Raporti i Komunës dhe shkollat

5	Sesionet informative për orientimin e karrierës	Sesionet informuese për orientim në karrierë duhet të mbahen me nxënësit që përfundojnë vitin e katërt të arsimit të mesëm	Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030	Komuna e Kërçovës dhe shkollat lokale	Janar 2023 – Qershor 2024		Në kuadër të programit ekzistues	Numri i sesioneve të mbajtura dhe numri i nxënësve të përfshirë / % e përfaqësimit gjinor	Raporti i Komunës dhe shkollat
---	---	--	---	---------------------------------------	---------------------------	--	----------------------------------	---	--------------------------------

## Kultura

Nr.	Masa / Aktiviteti	Rezultatet e pritura	Lidhja me dokumente të tjera strategjike	Institucionet kompetente	Afati kohor (nga-në)	Buxheti		Monitorimi/Vlerësimi	
						Vlerësimi buxhetor në denarë (MKD)	Burimi	Indikatori	Programi buxhetor
1	Sigurimi i mbështetjes dhe mjeteve për 8 Prillin – Ditën ndërkombëtare të Romëve	Të ndahen mjete për 8 prill	Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030	Komuna e Kërçovës	Janar 2023 – Qershor 2024		Programi dhe Buxheti ekzistues i Komunës	Ngjarja e mbajtur	Raporti i Komunës

**Plan për veprim për uljen e pasojave të KOVID-19 te komuniteti rom në periudhën pas KOVID  
në nivel lokal**

**Komuna e Kërçovës**

**Periudha e zbatimit**

**2023-2024**

**13 nëntor 2022**



## **1. HYRJE DHE ANALIZA E GJENDJES SË KOMUNITETIT ROM NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT PAS KOVID 19**

Pas shpalljes së pandemisë “Kovid 19” në mars të vitit 2020, shumë procese duhej të përshtateshin me realitetin e ri duke futur masa dhe plane konkrete për rimëkëmbjen dhe rehabilitimin nga pandemia. Përhapja e Kovid 19 po shkakton efekte të paparashikuara dhe të gjëra për të gjithë shoqërinë, për qeveritë nacionale dhe lokale, bizneset dhe veçanërisht për njerëzit e thjeshtë. Kriza shëndetësore, së bashku me krizat aktuale ekonomike, gjeneron kompleksitet të lartë, pasiguri dhe paparashikueshmëri në shoqëri, veçanërisht në nivel lokal. Rrjedhimisht, riorganizimi strukturor dhe zhvillimi i modeleve më efektive të integritit dhe koordinimit janë të nevojshme për situata të mundshme të ngjashme të krizës si në nivel nacional ashtu edhe në atë lokal, veçanërisht me fokus në grupet e marginalizuara të qytetarëve.

Para fillimit të pandemisë me KOVID-19, integrimi i komunitetit Rom në Republikën e Maqedonisë së Veriut shënoi një rritje të lehtë pozitive pothuajse në të gjitha sferat e jetës shoqërore: arsim, punësim, shëndetësi, banim, luftë kundër diskriminimit etj.

Me shpalljen zyrtare të pandemisë me KOVID-19, i gjithë sistemi u ridrejtu drejt krizës për shkak të situatës së re. Pandemia botërore në fakt ka zhvendosur rrjedhat sociale në të gjithë botën, duke përfshirë edhe vendin tonë. Pasojat e kësaj krize janë bërë gjithnjë e më të dukshme, sidomos për të papunët, personat me rrezik social dhe popullsinë më të marginalizuar siç është popullsia rome. Kriza me KOVID-19 vërtetoi se në situata kaq të rënda nuk ka hapësirë të mjaftueshme për zbatimin e masave gjithëpërfshirëse dhe integrimin kur bëhet fjalë për grupet e marginalizuara, në rastin e komunitetit Rom.

Gjatë pandemisë, Republika e Maqedonisë së Veriut si shtet ka zbatuar masa për zbutjen e pasojave të pandemisë me KOVID 19. Megjithatë, një pjesë e madhe e komunitetit Rom nuk i plotësonte kushtet për t'i përdorur këto masa, si përfshirja e fëmijëve Rom në arsimin parashkollor, monitorimi adekuat i mësimdhënies online në shkollat filllore dhe të mesme, trajtimi dhe kujdesi shëndetësor, qasja në lidhjen e internetit/kartat nga shteti, sigurimi i të ardhurave të përhershme, ruajtja e higjienës dhe mbrojtjes nga infektimet dhe sëmundjet ngjitëse të mundshme, qasja në ujë dhe energji elektrike. Të gjitha këto thelluan diskriminimin ndaj këtij komuniteti gjatë pandemisë me KOVID 19 si dhe në periudhën pas KOVID 19.

Në veçanti, problemet nga pandemia me KOVID 19 u ndjenë më së shumti në nivel lokal. Komunitat dhe Njësitë e vetëqeverisjes lokale ishin të përkushtuara për zgjidhjen e problemeve gjatë pandemisë, por fatkeqësisht për shkak të resurseve dhe kapaciteteve të kufizuara, komunitat nuk mundën dhe ende nuk mund të përgjigjen në mënyrë adekuate në situata të tilla krize siç është pandemia me koronavirusin KOVID 19.

Sipas analizës së Këshillit për bashkëpunim rajonal (KBR), problemet më kritike me të cilat përballlet komuniteti Rom gjatë pandemisë me KOVID 19, si dhe pasojat e saj në periudhën pas Kovid, janë identifikuar në fushat e mëposhtme: arsim, punësim, shëndetësi dhe banim.

Futja e mësimin në distancë apo online ka krijuar probleme serioze për nxënësit Rom. Nga njëra anë, mungesa e pajisjeve të TI, qasja në internet, energjia elektrike, si problem kryesor, të anketuarit deklaruan se është problem për ta të kuptojnë dhe përvetësojnë materialin përmes mësimin online në vend të pranisë fizike. Të dhënat e hulumtimit tregojnë se një numër i konsiderueshëm i nxënësve kanë rezultate të dobëta arsimore për shkak të ndikimit të KOVID

19. Analiza e realizuar nga KBR nxjerr në pah se 50% e prindërve deklaruan se fëmijët duhet të kthehen në shkollë. Si pasojë serioze e KOVID 19 është rritja e shkallës së braktisjes së shkollës (braktisja e procesit arsimor). E gjithë kjo rrit hendekun tashmë të konsiderueshëm në arsim midis nxënësve Rom dhe atyre jo-Rom<sup>11</sup>.

Grupi i parë më i prekur gjatë pandemisë ishin fëmijët Rom dhe e drejta e tyre për arsim. 3% e familjeve romë në Maqedoninë e Veriut nuk kanë qasje në energji elektrike, ndërsa 38% nuk kanë qasje në internet dhe 51% nuk kanë kompjuter.<sup>12</sup>

Projeksionet e raportit të UNICEF tregojnë se në Maqedoninë e Veriut përqindja e fëmijëve që jetojnë në ekonomitë familjare, standardi i jetës së të cilëve është dukshëm nën mesataren nacionale është rritur nga 27.8% para pandemisë në 32.4% pas pandemisë. Kjo i vendos 19.000 fëmijë në Maqedoninë e Veriut nën kufirin e varfërisë relative, që është më i lartë krahasuar me vlerësimin e korrikut të vitit 2020 për 16.000 fëmijë.<sup>13</sup>

Problem real sistemor është edhe ai se shkollat nuk kanë një sistem për mbledhjen e të dhënave për statusin social-ekonomik të fëmijëve Rom, gjë që do të mundësonte vlerësimin e nevojës për ndihmë gjatë qasjes në arsimin e duhur. Në fushën e shëndetësisë, krahas problemeve të shumta me të cilat Romët përballen në përgjithësi vazhdimisht, gjatë pandemisë, mungesa e qasjes në shërbimet shëndetësore u bë edhe më e rëndë për një sërë arsyesh, duke përfshirë:

- Distanca deri në spitalin më të afërt për 27% të Romëve është dy kilometra, dhe shtëpitë e rreth 12% të familjeve Rome nuk kanë qasje në një rrugë të asfaltuar<sup>14</sup>
- Qasja në ujë të pijshëm të pastër dhe mirëmbajtja e higjienës personale, rreth 10% e ekonomive familjare Rome në vend nuk kanë ujë të pijshëm brenda shtëpive të tyre, ndërsa 18% e ekonomive familjare nuk kanë qasje në sistemin e kanalizimit<sup>15</sup>
- Kushtet e këqija në të cilat jetojnë dhe vendbanimet Rome kryesisht janë afër deponive të egra
- Mungesa e mjeteve financiare kontribuoi në pamundësinë për të siguruar produkte të mjaftueshme për higjienë personale
- Informimi i pamjaftueshëm për vaksinat dhe procesin e vaksinimit

---

<sup>11</sup> Ndikimi socio-ekonomik i KOVID 19 mbi Romët në Ballkanin Perëndimor, Raport i Këshillit për bashkëpunim rajonal, dhjetor 2021 (faqe 51);

<sup>12</sup> Sfidat për Romët gjatë krizës së shkaktuar nga KOVID 19, Raport i Institutit për politika evropiane Shkup, maj 2020

<sup>13</sup> <https://www.unicef.org/northmacedonia/press-releases/not-all-children-are-accessing-vital-services-due-covid-19-pandemic-putting-them>

<sup>14</sup> Sfidat për Romët gjatë krizës së shkaktuar nga KOVID 19, Raport i Institutit për politika evropiane Shkup, maj 2020

<sup>15</sup> Sfidat për Romët gjatë krizës së shkaktuar nga KOVID 19, Raport i Institutit për politika evropiane Shkup, maj 2020

Sipas hulumtimit të UNDP-së dhe Bankës Botërore, përqindja e Romëve të përfshirë në papunësi joformale është ulur në periudhën e viteve 2011-2017 me 26 pikë përqindje, duke arritur në 38%. Sipas të dhënave nga Programi i reviduar për reforma në punësimin dhe politikën sociale, mesatarisht 25% e popullsisë punon në mënyrë joformale. Forma më e zakonshme e punësimit joformal te meshkujt Rom është në tregti, shërbime taksit, si dhe në ndërtimtarit dhe bujqësi, ndërsa te femrat Romë forma më e zakonshme e punësimit është në tregti dhe shërbime higjienike. Shumë familje Romë mbështeten në punën sezonale në stinën e verës gjatë sezonit të korrjes. Rreth 48% e familjeve Romë janë përdoures të ndihmës sociale<sup>16</sup>.

Sipas të dhënave të hartëzimit social nga viti 2018, shkalla e punësimit të Romëve është 23%, pothuajse dyfishi i mesatares nacionale, ndërsa shkalla e papunësisë së Romëve është në nivel rekord prej 67%. Te gratë Romë, shkalla e punësimit është 8%.<sup>17</sup>

Romët, veçanërisht gruaja Romë, prej kohësh janë prekur fuqishëm nga papunësia. Përhapja e koronavirusit vetëm sa i përkeqësoi gjërat. Shumë nga familjet Romë që punonin në mënyrë joformale ose sezonale humbën vendet e tyre të punës për shkak të masave dhe kufizimeve në lëvizje. Analizat konfirmojnë se për shkak të pandemisë, rrogat janë ulur dhe rreth 61% e të anketuarve janë të shqetësuar se mund të humbasin punën në 12 muajt e ardhshëm, si pasojë e krizës me KOVID 19.<sup>18</sup>

Ndikimi i krizës së koronavirusit u reflektua veçanërisht në tregun e punës, si në atë formal ashtu edhe në atë joformal, ku në kushtet e uljes së kërkesës dhe ofertës, ekonomia vendore (sektori real) u përball me sfida të shumta. Pandemia me Kovid 19 pati një ndikim të madh edhe në komunitetin Rom: një numër i madh i Romëve që ishin të punësuar formalisht u pushuan nga puna ose punonin me gjysëm orar të punës, një numër i madh i sipërmarrësve Romë mbyllën kompanitë e tyre, tregtarët joformal nuk ishin në gjendje të shesin për shkak të kufizimeve të shumta, një numër i konsiderueshëm i Romëve të punësuar për mirëmbajtjen e higjienës ndërpreu aktivitetin e tyre, ndërkohë që grumbulluesit joformalë të lëndëve të para sekundare u përballën me uljen e çmimeve të blerjes, por edhe me pamundësinë për të shitur lëndën e parë të tyre. Kjo gjendje padyshim se ka ndikuar në rritjen e papunësisë te komuniteti Rom, por veçanërisht është pasqyruar në rritjen e rrezikut të varfërisë.<sup>19</sup>

Për uljen e papunësisë, në kuadër të planit operativ të punësimit, parashikohen masa për punëdhënësit për t'i inkurajuar ata të punësojnë Romët ose të zhvillojnë bizneset e tyre, si dhe masa për rritjen e aftësive të të papunëve. Mesatarisht, rreth 3-4% e Romëve kanë qenë përdoures të masave aktive të punësimit në vitet e fundit dhe megjithëse numri absolut i përdouresve Romë po rritet, pjesa relative e numrit të përgjithshëm të përdouresve të mbuluar nga masat aktive të punësimit mbetet e pandryshuar.<sup>20</sup> Për shumë arsye, Romët përballen me rreziqe më të mëdha për t'u prekur nga një virus, infeksion apo ndonjë sëmundje tjetër e ngjashme me KOVID 19, por edhe nga zhvillimi i komplikimeve shëndetësore. Përqindja e lartë e sëmundjeve kronike afatgjata kontribuojnë në vdekjen e përsheptuar dhe të parakohshme të kësaj popullsie të qytetarëve. Analizat tregojnë se mesatarisht Romët jetojnë 10

<sup>16</sup>Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030 / [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

<sup>17</sup>Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030 / [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

<sup>18</sup>Ndikimi socio-ekonomik i KOVID 19 mbi Romët në Ballkanin Perëndimor, Raport i Këshillit për bashkëpunim rajonal, dhjetor 2021 (faqe 51);

<sup>19</sup>Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030 / [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

<sup>20</sup>Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030 / [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

vjet më pak se popullsia e përgjithshme. Jetëgjatësia e shkurtër e Romëve është dokumentuar në shumë raporte, me çrast rezultatet e Entit shtetëror për statistika tregojnë se 7% e komunitetit Rom vdesin në moshën 25-44 vjeç, ndërsa 37% vdesin në moshën 45-64 vjeç. Rreth 49% vdesin në moshë ndërmjet 65-84 vjeç, me vetëm 7% që jetojnë deri në moshën 85 vjeç. Nëse krahasojmë me pensionin e pleqërisë, vetëm 45% e Romëve mund të presin pension të pleqërisë, ndërsa te Jo-Romët, përqindja është mesatarisht 75%.<sup>21</sup> Edhe para pandemisë me KOVID 19, një numër i konsiderueshëm i Romëve kanë pasur probleme me qasjen në shërbimet shëndetësore, veçanërisht personat që nuk janë të identifikuar në sistem, personat që nuk kanë dokumente personale dhe nuk kanë sigurim shëndetësor. Informacionet e fundit zyrtare të Ministrisë së punës dhe politikës sociale flasin për një numër prej rreth 700 personash që nuk kanë sigurim shëndetësor për shkak të mungesës së dokumentacionit personal, por sipas organizatave joqeveritare ky numër është shumë më i lartë. Prandaj, Romët në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë të ekspozuar ndaj një rreziku që është rritur edhe më shumë me pandeminë. Sa i përket kohës së pandemisë, sipas disa analizave të caktuara, janë identifikuar probleme shtesë si: mungesa e qasjes përkatëse dhe të mjaftueshme në mjete mbrojtëse për dezinfektim, qasje joadekuate në informacione si dhe probleme me shëndetin emocional, mendor dhe fizik si ndikim i kufizimeve gjatë pandemisë<sup>22</sup>.

90% e lagjeve ku jetojnë Romët në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë joformale dhe nuk janë të mbuluara nga Plani detal urbanistik. Kjo sjell një sërë problemesh komplekse si: kushte joadekuate të jetesës, infrastrukturë të dobët, mungesë të qasjes në kanalizimin fekal dhe atmosferik, mungesa e qasjes në ujë dhe energji elektrike. Familjet Rome zakonisht jetojnë në shtëpi individuale, me një numër më të madh anëtarësh të familjes. Gjatë pandemisë, familjet e tilla kishin probleme serioze me hapësirën për izolim dhe ruajtjen e distancës sociale kur kishin një anëtar të familjes të sëmurë, mbajtjen e higjienës dhe mbrojtjes të duhur.

Sipas Raportit rajonal për Romët nga viti 2017 të realizuar nga UNDP për vendet e Ballkanit Perëndimor, gjendja në aspektin e infrastrukturës në Republikën e Maqedonisë së Veriut është si vijon:

- 10% e Romëve nuk kanë qasje në ujë
- 16% e Romëve nuk kanë qasje në kanalizimin publik
- 26% e Romëve nuk kanë tualete në shtëpi
- 7% e Romëve nuk kanë qasje në energji elektrike<sup>23</sup>

---

<sup>21</sup>Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030 / [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

<sup>22</sup>Ndikimi socio-ekonomik i KOVID 19 mbi Romët në Ballkanin Perëndimor, Raport i Këshillit për bashkëpunim rajonal, dhjetor 2021 (faqe 54);

<sup>23</sup>Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030 / [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

Edhe pse këto probleme nuk janë pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë me KOVID 19, ato përfaqësojnë kushtet themelore për ruajtjen e higjienës dhe mbrojtjes adekuate me qëllim të parandalimit të përhapjes së sëmundjeve apo infeksioneve si KOVID 19. Përveç asaj, si problem serioz është theksuar problemi i legalizimit të shtëpive të ndërtuara pa leje te komuniteti rom, i cili në afat të gjatë krijon pasoja të rënda për jetën e familjeve rome.

Sipas analizave të mëparshme dhe të dhënave nga hartëzimi social, rreth 28% e romëve nuk kanë legalizuar vendbanimet e tyre për shkak të mungesës së një plani urbanistik në komunë për ato vendbanime ose për shkak të pamundësisë për të mbuluar shpenzimet financiare. Gjithashtu, qytetarët që kanë paraqitur kërkesa për legalizimin e objekteve të tyre kanë më shumë se 5 vite që presin përgjigje nga institucionet kompetente lidhur me statusin e kërkesës së tyre.

Rrjedhimisht, kushtet e këqija në fushën e banimit ndikojnë në qasjen në arsim, shërbimet shëndetësore, punësim dhe të drejta të tjera themelore të njeriut, të cilat duhet të jenë të disponueshme për çdo individ. Mungesa e një qasje të tillë e bën komunitetin të marginalizuar, të varfër dhe të paarsimuar, të kufizuar në lagjet e veta (komunitete të segreguara).<sup>24</sup>

Sipas raportit të Kombeve të Bashkuara për Republikën e Maqedonisë së Veriut, KOVID 19 ka një ndikim të rëndësishëm në integrimin dhe gjithëpërfshirjen e komunitetit rom. Raporti përmend se “Romët si komunitet gjatë pandemisë me KOVID 19 kanë mbetur shumë prapa në krahasim me të tjerët, duke u përballur me qasje jashtëzakonisht të vështirë në nevojat themelore të higjienës dhe të jetesës dhe pothuajse asnjë mundësi që fëmijët Rom të vazhdojnë arsimimin e tyre siç duhet”.<sup>25</sup>

Sipas Udhëzuesit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për mbështetjen e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi dhe urrejtja gjatë pandemisë me Kovid-19 dhe krizave të ngjashme në të ardhmen, shteteve u jepen rekomandime se si të mbështesin procesin e rimëkëmbjes veçanërisht për grupet më të marginalizuara të qytetarëve si komuniteti rom.

Sipas rekomandimeve të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, rekomandohet që vetëqeverisjet lokale të marrin masa aktive për shërbimet sociale që lidhen me krizat, si beneficionet për banimin, shëndetin dhe punësimin, dhe të sigurojnë që ato të arrijnë anëtarët e grupeve të rrezikuara. **(rekomandimi 6)**. Nga ana tjetër, Komiteti i Ministrave rekomandon mbledhjen e të dhënave të ndara në lidhje me numrin dhe gjendjen e personave që u përkasin grupeve të ndryshme të pakicave dhe grupeve të disavantazuara, në mënyrë që të sigurohet një bazë për përcaktimin e ndikimit të pandemisë në aspektin e diskriminimit dhe barazisë **(rekomandimi 7)**. Është veçanërisht e rëndësishme që Komiteti rekomandon sigurimin e qasjes adekuate në shërbimet e rregullta shëndetësore për Romët dhe grupet tjera të rrezikuara, si në interes të tyre ashtu edhe për kontrollin më të mirë të përhapjes së virusit **(rekomandimi 10)**. Për sa i përket kushteve sanitare dhe të jetesës, Komiteti rekomandon që kushtet e jetesës në vendbanimet Rome duhet të përmirësohen për të parandaluar përhapjen e viruseve, duke përfshirë sigurimin e ujit të freskët të rrjedhshëm dhe kapaciteteve për largimin e

---

<sup>24</sup>Strategjia për gjithëpërfshirjen e Romëve 2022-2030 / [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

<sup>25</sup>KOVID 19 – Korniza për përgjigje për Maqedoninë e Veriut, Raport i Kombeve të Bashkuara;

mbeturinave (**rekomandimi 11**). Në lidhje me arsimin, rekomandohet që strategjitë arsimore për mësim të vazhdueshëm për të gjithë fëmijët të përfshijnë konsultimin me pjesëtarët e komuniteteve të rrezikuara, pakicat. Duhet gjithashtu të futen masa për të kapërcyer hendekun digjital në tranzicionin drejt zgjidhjeve online për vazhdimësi në arsim, si mbështetje shtesë dhe e përshtatur për nxënësit nga komunitetet e disavantazuara dhe pakicat. (**rekomandimi 12**). Kompensimet për personat e papunë duhet të jenë të disponueshme për të mbuluar ata që punojnë në ekonominë joformale dhe punëtorët sezonalë. Duhet t'u ofrohet ndihmë grupeve të rrezikuara se si të aplikojnë për beneficione. Duhet të vendosen sanksione për mosrespektimin e standardeve të shëndetit dhe sigurisë në punë për të parandaluar eksploatimin e punëtorëve nga grupet e rrezikuara (**rekomandimi 13**). Për sa i përket garantimit të një niveli të lartë të respektimit për diversitetin në kohë të krizës, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës vë në dukje se dobësitë në përballjen me diversitetin i bëjnë vendet më të rrezikuara në reagimin efektiv ndaj një pandemie si Kovid-19. Antidiskriminimi, diversiteti dhe përfshirja duhet të jenë prioritetet kryesore strategjike për rezultate më të mira në menaxhimin e krizave dhe situatat e krizës në të ardhmen (**rekomandimi 16**)<sup>26</sup>.

Duke marrë parasysh analizat dhe rekomandimet e sipërpërmendura, vërtetohet se komuniteti rom, si komuniteti më i marginalizuar, është më i prekuri nga ndikimi i KOVID 19. Prandaj, dhe për të rimëkëmbur ndikimin socio-ekonomik të pandemisë me KOVID 19 në komunitetin rom, komuna përpiqet të gjejë një mënyrë për të ofruar mbështetje sistimore, strukturore për rehabilitimin dhe rimëkëmbjen e komunitetit rom nga problemet afatgjata që janë përkeqësuar më tej si pasojë e KOVID 19.

Për këtë qëllim, programi i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian ROMA TED 2 mbështet komunën për të zhvilluar një Plan për veprim për reduktimin e pasojave të shkaktuara nga KOVID 19 mbi komunitetin rom.

## 2. PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIT PËR VEPRIM

Për të përcaktuar siç duhet problemet kryesore që janë pasojë dhe ndikim i krizës së KOVID 19 mbi komunitetin rom, u realizuan takime konsultative me përfaqësues të 15 komunave, pjesëmarrës të grupeve institucionale të formuara në kuadër të programit ROMA TED dhe përfaqësues të komunitetit.

Për fazën e parë u zhvilluan dy pyetësorë. Një pyetësor ishte i dedikuar për përfaqësues të komunave dhe institucioneve lokale, ndërsa pyetësori i dytë ishte për përfaqësues të komunitetit rom. Qëllimi i pyetësorëve ishte identifikimi i problemeve kryesore që kanë lindur si pasojë e KOVID 19 mbi komunitetin rom, si dhe masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga vetëqeverisja lokale dhe organizata të tjera për të ndihmuar komunitetin rom gjatë pandemisë. Pyetësorët mbuluan gjithsej 30 të anketuar (një pyetësor për komunë për administratën dhe një për përfaqësuesin e komunitetit në bashkëpunim me facilitatorin).

---

<sup>26</sup>Udhëzues i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për mbështetjen e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi dhe urrejtja gjatë pandemisë Kovid-19 dhe krizave të ngjashme në të ardhmen.

Faza e dytë përbëhet nga fokus grupe me përfaqësues të grupeve institucionale të formuara nga programi ROMACTED në 15 komuna si dhe me facilitator të angazhuar në kuadër të programit. Qëllimi i këtyre fokus grupeve ishte diskutimi më i detajuar me përfaqësues të komunave dhe institucioneve lokale lidhur me problemet e shkaktuara nga KOVID 19 si dhe gjetja dhe përcaktimi i zgjidhjeve që do i ndihmojnë komunitetin rom të kapërcejë problemet të cilat i trashëguan nga pandemia. Në fokus grupe ishin përfshirë rreth 30 pjesëmarrës.

Në bazë të gjetjeve dhe rekomandimeve, ky plan për veprim është zhvilluar për të reduktuar pasojat e KOVID 19 mbi komunitetin rom.

Qëllimi i këtij plani për veprim është të ndihmojë komunën të zhvillojë një strategji/plan për veprim të përshtatshëm që do t'i ndihmojë komunitetin rom të kapërcejë problemet e shkaktuara nga KOVID-19 dhe të cilat ata po i përjetojnë ende si pasojë e krizës. Nga ana tjetër, ky proces do t'i ndihmojë komunës që në mënyrë adekuate të përforcojë kapacitetet e saj për planifikim strategjik dhe menaxhimin e krizave të mundshme të ngjashme dhe fatkeqësive natyrore, si dhe të planifikojë në mënyrë adekuate masat për të mbështetur kategoritë më të rrezikuara të qytetarëve, përveç në situata krize dhe të përditshme me problemet me të cilat përballen ata si anëtarë të një grupi të marginalizuar.

Ky proces mbështetet nga programi ROMAKTED 2, i cili është një program i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian dhe realizohet nga Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Institutin për hulumtime dhe analiza Romalitiko.

Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian përmes programit ROMAKTED 2 do u ndihmojnë komunave përmes granteve të vogla për të realizuar një pjesë të aktiviteteve të planifikuara në këtë plan për veprim dhe do të ndihmojnë në zgjidhjen e drejtpërdrejtë të problemeve me të cilat përballen romët si pasojë e KOVID 19.

Me këtë, komuna detyrohet të miratojë këtë plan për veprim në përputhje me Memorandumin e nënshkruar për bashkëpunim si plan të veçantë për veprim ose në kuadër të një plani tjetër për veprim në nivel lokal dhe të sigurojë kornizë adekuate buxhetore për realizimin e aktiviteteve të parapara në vetë planin për veprim, duke shfrytëzuar mjetet personale buxhetore, mjete nga programi ROMAKTED 2 dhe mjete nga donatorë të tjerë.

Ky plan për veprim do të realizohet në periudhën nga janari 2023 deri në qershor 2024.

**Në rast të një krize të përsëritur me KOVID ose një krizë tjetër të ngjashme gjatë zbatimit të planit të veprimit, ekziston mundësia për të ndryshuar aktivitetet në veprime urgjente sipas nevojave reale në terren të popullsisë Rome, si p.sh. sigurimi i pakove higjienike, pakove me ilaçe, vaksinimit dhe të ngjashme me pëlqimin paraprak të donatorit dhe Këshillit të komunës.**

**Qëllimi kryesor: Kontributi në tejkalimin e pasojave të KOVID 19 te komuniteti rom në komunën e Kërçovës**

**Qëllimi specifik: Zbatimi i masave të duhura për të përmirësuar situatën e komunitetit rom në përgjigje të pasojave nga KOVID 19 në arsim dhe punësim.**

Nr .	Masa / Aktiviteti Measure/ Activity	Rezultatet dalëse / Outputs	Rezultat / Outcomes	Lidhja me dokumente të tjera strategjike Connection with other strategic documents	Institucione t kompetente /Responsible institutions	Afati kohor (nga-në) /Deadline	Buxheti/ Budget		Monitorimi/Vlerësimi Monitoring/Evaluation		
							Vlerësimi buxhetor në denarë (MKD) Budget Estimation in MKD	Burimi Source	Të dhënat bazë / Baseline Data	Indikator Indicator	Burimi Source
1	Përfundimi i nivelit të katërt të arsimit të mesëm formal për 3 të rritur Rom dhe punësimi i tyre në kompanitë lokale	- Përfshirja e të rriturve Rom në një program edukimit të mëtejshëm - Zbatimi i programit të arsimit të mëtejshëm - Dhënia e diplomave për arsimin e mesëm të kryer -Vendim/kontrata për punësimin e të rriturve Rom	- Rritja e numrit të të rriturve Rom me arsim të përfunduar - Rritja e numrit të të punësuarve Rom të rritur që ishin të papunë në afat të gjatë - Përmirësimi i gjendjes social-ekonomike të 3 familjeve në periudhën post-KOVID	Strategjia Nacionale për Romët 2022-2030  ROMAKTE D Vlerësimi i nevojave të komunitetit 2021	Komuna	Janar 2023 – Qershor 2024	122.850,00	Programi ROMAKTED	3,26% e Romëve kanë përfunduar arsimin fillor në vitin akademik 2019/2020 (Burimi: Enti shtetëror për statistika)  8,7% e Romëve kanë përfunduar arsimin e mesëm të paplotë (me tre vjet) për vitin akademik 2019/2020, ndërsa 1,2% kanë përfunduar arsimin e mesëm me gjithsej katër vite për vitin	- 3 Rom të rritur me shkollës së mesme të përfunduar, 1 prej të cilëve duhet të jetë grua - Të punësohen 3 Rom të rritur, 1 prej të cilëve duhet të jetë grua	Raporti i APRMV



									akademik 2019/2020 (Burimi: Enti shtetëror për statistika)		
									67% Rom të papunë (burimi: Strategjia për Romët 2022- 2030)		
2	Zbatimi i mësimdhënies me tutor për 30 nxënësit më të dobët Rom që përfshihen në klasat e 2, 3 dhe 4 të arsimit fillor, të cilët tregojnë sukses të ulët arsimor si pasojë nga KOVID 19	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Thirrje publike për angazhimin e tutorëve</li> <li>- Lista e nxënësve të identifikuar me sukses të dobët</li> <li>- Programi i zhvilluar i tutorit</li> <li>- Numri i orëve të realizuara me tutor</li> </ul>	Përmirësimi i performancës arsimore të nxënësit Rom	Strategjia Nacionale për Romët 2022-2030  ROMAKTE D Vlerësimi i nevojave të komunitetit 2021	Komuna dhe shkollat fillore lokale	Janar 2023 – Qershor 2024	275.940,00	Programi ROMAKTED	Nuk ka të dhëna përkatëse për efektet negative të pandemisë në cilësinë e arsimit. Sipas anketës të fundit të UNICEF-it në vend, 77% e mësimdhënësve kanë deklaruar se nuk kanë mundur të kontaktojnë me disa nga nxënësit e tyre në një moment të caktuar të vitit shkollor në vitin 2020, ndërsa në vitin 2021 kjo përqindje është ulur në 63%.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i fëmijëve të përfshirë në mësimdhënien me tutor, nga të cilët 50% duhet të jenë vajza</li> <li>- janë angazhuar 5 tutorë për të zbatuar mësimdhënien me tutorë</li> <li>- Numri i orëve të realizuara me tutor</li> <li>- Të paktën 65% e nxënësve kanë rritur suksesin e tyre</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kontratat për tutorët e angazhuar</li> <li>- Raport nga shkollat fillore për realizimin e mësimdhënies me tutor</li> <li>- Dëftesa nga nxënësit</li> <li>- Fotografi nga ngjarjet</li> </ul>
3	Organizimi i takimeve informative dhe konsultative me të rinjtë dhe të rriturit Rom të papunë me	<ul style="list-style-type: none"> <li>- janë organizuar takime informuese dhe konsultative me të rinjtë dhe të rriturit Rom me punëdhënësit</li> <li>- Ata</li> </ul>	-Rritja e informimit të komunitetit rom për mundësitë e punësimit në	Strategjia Nacionale për Romët 2022-2030	Komuna, punëdhënësit dhe kompanitë e biznesit dhe OJQ-të Rome	Janar 2023 – Qershor 2024	189.000,00	Donacion ose kuadër të një programi ekzistues	Nuk ka asnjë program për informimin e rregullt të të rinjve dhe të Romëve të	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i takimeve të realizuara</li> <li>- Numri i të rinjve dhe të rriturve rom të pranishëm, 50% e të cilëve duhet të jenë gra</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Listat e të pranishmëve</li> <li>- Procesverbale nga takimet</li> <li>- Fotografi nga takimet</li> </ul>

	<p>punëdhënësit lokal/agjencitë afariste për punësim për t'i informuar ata për mundësitë e punësimit në nivel lokal si dhe kualifikimet e nevojshme në mënyrë që ata të mund të punësohen siç duhet në bizneset dhe ekonominë ekzistuese në nivel lokal.</p>	<p>përgatitën një listë të kompanive të përfshira në proces Është zhvilluar baza e të dhënave me të rinjtë dhe të rriturit Rom të interesuar për punësimin e tyre</p>	<p>nivel lokal Rritja e shkallës së punësimit të të rriturve dhe të rinjve Rom në nivel lokal</p>	<p>ROMAKTE D Vlerësimi i nevojave të komunitet it 2021</p>					<p>papunë dhe orientimin e tyre në karrierë</p>	<p>- Numri i kompanive të interesuara për të mbështetur punësimin e Romëve në nivel lokal</p>	
4	<p>Punësimi i 5 të rinjve dhe të rriturve Rom të papunë në kompani private në nivel lokal për të paktën një vit</p>	<p>- Janë punësuar 5 të rinj dhe të rritur Rom</p>	<p>- Rritja e shkallës të punësimit të komunitetit Rom në nivel lokal - Përmirësimi i gjendjes socio-ekonomike të komunitetit Rom në periudhën pas Covid</p>	<p>Strategjia Nacionale për Romët 2022-2030  ROMAKTE D Vlerësimi i nevojave të komunitet it 2021</p>	<p>Komuna dhe Qendra për punësim</p>	<p>Janar 2023 – Qershor 2024</p>	<p>1.553.580 ,00</p>	<p>Në kuadër të buxhetit të kompanive private</p>	<p>Nuk ka të dhëna të ndara për punësimin e të rinjve Rom në nivel lokal</p>	<p>- Numri i personave të punësuar, nga të cilët një % përkatëse duhet të jenë gra</p>	<p>- Kontrata për punësimin e personave nga komuniteti Rom për të paktën një vit</p>
5	<p>Përfshirja e 10 të rinjve dhe të rriturve të papunë Rom përmes masave aktive të punësimit dhe përfshirjes së tyre në tregun e punës</p>	<p>- 10 Rom të rinj dhe të rritur të përfshirë në masa aktive për punësim - Aftësi dhe kualifikime të përmirësuara - Të rinjtë dhe të rriturit Rom të punësuar që kanë përfunduar me</p>	<p>- Rritja e konkurrencës së tregut të punës te popullsia Rome; - Rritja e shkallës të punësimit të</p>	<p>Strategjia Nacionale për Romët 2022-2030  ROMAKTE D</p>	<p>Komuna dhe Qendra për punësim</p>	<p>Janar 2023 – Qershor 2024</p>	<p>3.024.000 ,00</p>	<p>Në kuadër të Buxhetit të miratuar të APRMV-së për zbatimin e Planit operativ për punësim për vitin 2023</p>	<p>4% e romëve janë përdorues të masave aktive të punësimit në vitet e fundit (Burimi: Strategjia</p>	<p>- Numri i të rinjve Rom të përfshirë në masa aktive për punësim, nga të cilët 50% duhet të jenë gra - 70% e të përfshirëve kanë rritur aftësitë dhe</p>	<p>- Kontrata për praktikant për 10 të rinj Rom Vendim/kontratë për punësimin e 5 të rinjve Rom në kompani private për të</p>

		sukses programin	komunitetit Rom në nivel lokal -Përmirësimi i gjendjes socio-ekonomike të komunitetit Rom në periudhën pas Covid	Vlerësimi i nevojave të komunitetit 2021					Nacionale për gjithëpërfshirjen e Romëve (2022-2030)	kualifikimet e tyre - Janë punësuar 50% e të rinjve dhe të rriturve Rom që morën pjesë në program	paktën 6 muaj
6	Organizimi i trajnimeve për 120 të rinj Rom për të përforcuar aftësitë e tyre për kërkim aktiv të punës (CV, intervistë, letër motivimi) dhe për të qenë më konkurrues në tregun e punës	- Është zhvilluar programi për trajnim -Lista e të rinjve Rom të identifikuar -Trajtime të realizuara për të rinjtë Rom në nivel lokal -Të paktën 70% e pjesëmarrësve kanë rritur aftësitë dhe njohuritë e tyre për kërkim aktiv të punës	- Rritja e aftësive dhe njohurive për kërkim aktiv të punës të të rinjtë Rom -Përmirësimi i mundësive për konkurrencë në tregun e punës të të rinjtë Rom	Strategjia Nacionale për Romët 2022-2030  ROMAKTE D Vlerësimi i nevojave të komunitetit 2021	Komuna	Janar 2023 – Qershor 2024	151,200,00	Donacion	Nuk ka të dhëna të ndara për pjesëmarrjen e të rinjve Rom në trajnime të ngjashme	- Numri i të rinjve të identifikuar - Numri i të rinjve të përfshirë - Numri i trajnimeve të realizuara - Numri i pjesëmarrësve që kanë përmirësuar aftësitë dhe njohuritë e tyre - Numri i grave të përfshira në program (minimumi 50%)	- Listat e të pranishmëve - Procesverbale nga takimet - Fotografi
7	Sigurimi i kontrollave të rregullta pa pagesë për Romët me rrezik social, ofrimi i kujdesit adekuat shëndetësor dhe reduktimi i pasojave mbi shëndetin e tyre si pasojë e KOVID 19	- Janë identifikuar familjet me rrezik social - Janë realizuar kontrollat të rregullta pa pagesë - Së paku 80% e familjeve morën mbrojtje dhe këshillim parandalues në kohë	- Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të komunitetit Rom nëpërmjet kontrollave parandaluese në nivel lokal	Strategjia Nacionale për Romët 2022-2030  ROMAKTE D Vlerësimi i nevojave të komunitetit 2021	Komuna dhe Shtëpia e shëndetit	Janar 2023 – Qershor 2024	94.500,00	Në kuadër të programeve ekzistuese të Ministrisë së shëndetësisë për ofrimin e kontrollave pa pagesë	Në kuadër të Ministrisë së shëndetësisë ekzistojnë programe të veçanta që sigurojnë mbrojtje shëndetësore pa pagesë me një synim të veçantë Romët dhe gratë Rome, si për shembull PAP teste pa pagesë te gjinekologu.  21% e grave	- Numri i familjeve të vizituara - Numri i kontrollave të realizuara pa pagesë  - Numri i familjeve që kanë marrë mbrojtje adekuate parandaluese në kohë  - Numri i grave që kanë realizuar	Raporte nga shtëpia e shëndetit dhe komuna  Lista e familjeve të vizituara  Fotografi nga vizitat

									Rome nuk vizitojnë gjinekologun gjatë shtatzënisë (burimi: Raporti i ROMAKTED për aktivitetin për KOVID 2021)	kontrolla përkatëse	
8	Organizimi i fushatave informuese dhe takimeve me komunitetin Rom për ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e vaksinimit kundër virusit KOVID 19, si dhe kryerja e kontrollave të rregullta dhe ruajtja e shëndetit publik, veçanërisht në periudhën pas KOVID 19.	- Janë organizuar takime informuese me komunitetin në nivel lokal - Janë realizuar vizita në terren në vendbanimet rome	- Rritja e informimit të komunitetit rom për ruajtjen e shëndetit personal si dhe rëndësia e vaksinimit dhe mbrojtjes së shëndetit kolektiv	Strategjia Nacionale për Romët 2022-2030  ROMAKTE D Vlerësimi i nevojave të komunitetit 2021	Komuna, Shtëpia e shëndetit dhe OJQ-të rome	Janar 2023 – Qershor 2024	75,600.00	Në kuadër të programit ekzistues të Ministrisë së Shëndetësisë.	42.2% e romëve që vizituan mjekun-specialist ishin diskriminuar Ndërsa 44.8% u diskriminuan gjatë qëndrimit në spital (Burimi: Raporti i ROMAKTED për aktivitetin e KOVID 2021)	- Numri i takimeve informative të realizuara - Numri i pjesëmarrësve në takime - Rritet numri i personave të vaksinuar kundër KOVID 19  - Numri i grave që morën pjesë në takime dhe morën informacionin e duhur	Procesverbalet Listat e të pranishmëve Fotografi
9	Sigurimi i lidhjes me ujë të pijshëm dhe cilësor për të paktën 5 familje me rrezik social nga komuniteti rom me qëllim që të sigurohen kushte të përshtatshme sanitare dhe higjienike si parakusht themelore për mbrojtjen kundër KOVID-19 dhe	- Lista e familjeve të identifikuara - Familjet e lidhura në rrjetin e ujësjellësit	- Përmirësimi i kushteve sanitare dhe kushteve themelore të jetës së Romëve në nivel lokal	Strategjia Nacionale për Romët 2022-2030  ROMAKTE D Vlerësimi i nevojave të komunitetit 2021	Komuna dhe Ndërmarrja publike për higjienën komunale	Janar 2023 – Qershor 2024	110.250,00	Në kuadër të programit dhe buxhetit ekzistues të NPK	10% e Romëve nuk kanë qasje në ujë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Burimi: Strategjia Nacionale për Romët 2022-2023)	Numri i familjeve me rrezik social të lidhura në rrjetin e ujësjellësit	Vendim për lidhje  Raport për familjet e lidhura në rrjetin e ujësjellësit

	sëmundjeve të tjera ngjitëse.										
10	Sigurimi i lidhjes në kanalizimin fekal për të paktën 5 familje me rrezik social nga komuniteti rom me qëllim që të sigurohen kushte të përshtatshme sanitare dhe higjienike si parakusht themelore për mbrojtjen kundër KOVID-19 dhe sëmundjeve të tjera ngjitëse	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lista e familjeve të identifikuara</li> <li>- Familjet e lidhura me rrjetin kryesor fekal</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirësi mi i kushteve sanitare dhe kushteve themelore të jetës së Romëve në nivel lokal</li> </ul>	Strategjia Nacionale për Romët 2022-2030  ROMAKTE D Vlerësimi i nevojave të komunitetit 2021	Komuna dhe Ndërmarrja publike për higjienën komunale	Janar 2023 – Qershor 2024	110.250,00	Në kuadër të programit dhe buxhetit ekzistues të NPK	10% e Romëve nuk kanë qasje në ujë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Burimi: Strategjia Nacionale për Romët 2022-2023)	Numri i familjeve me lidhura në rrjetin fekal	<p>Vendim për lidhje</p> <p>Raporti për familjet e lidhura në rrjetin fekal</p>
11	Sigurimi i lidhjes në energjinë elektrike për të paktën 5 familje me rrezik social nga komuniteti rom me qëllim që të sigurohen kushte të përshtatshme sanitare dhe higjienike si parakusht themelore për mbrojtjen kundër KOVID 19 dhe sëmundjeve të tjera ngjitëse	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lista e familjeve të identifikuara</li> <li>- Familje të lidhura në energjinë elektrike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirësi mi i kushteve themelore të jetës së Romëve në nivel lokal</li> </ul>	Strategjia Nacionale për Romët 2022-2030  ROMAKTE D Vlerësimi i nevojave të komunitetit 2021	Komuna dhe EVN	Janar 2023 – Qershor 2024	157.500,00	Në kuadër të Programit ekzistues të Qeverisë dhe Vetëqeverisjes Lokale	7% e Romëve nuk kanë qasje në energji elektrike në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Burimi: Strategjia Nacionale për Romët 2022-2023)	Numri i familjeve me rrezik social të lidhura me energji elektrike	<p>Vendim për lidhje</p> <p>Raport për familjet e lidhura me energjinë elektrike</p>
12	Përgatitja e strategjisë dhe planit për veprim për komunën për	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Janë organizuar takime konsultative në nivel komunal</li> <li>- Është formuar një grup i punës për të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirësi mi i menaxhimit strategjik të komunave për</li> </ul>	Strategjia për Romët 2022-2030	Komuna	Janar 2023 – Qershor 2024	189.000,00	Programi ROMAKTED	Nuk ka një Plan për rrezik për grupat e rrezikuara ,	Është miratuar Plani për rrezik për grupet e rrezikuara në nivel lokal në rast të krizave	Miratimi i planit nga Këshilli i komunës

	menaxhimin me rreziqet dhe fatkeqësive natyrore për të mundësuar një sistem strategjik për menaxhimin e situatave eventuale të ngjashme si KOVID 19 dhe zbutja e pasojave për grupet e rrezikuara të qytetarëve si Romët	zhvilluar strategjinë - Është hartuar strategjia dhe plani për veprim për menaxhimin e rreziqeve	përballimin e rreziqeve dhe fatkeqësive natyrore	ROMAKTE D Vlerësimi i nevojave të komunitetit 2021					qoftë në nivel nacional apo lokal. Ky del si një mësim i nxjerrë nga kriza me pandeminë.	
--	--	--	--	---	--	--	--	--	--	--



*Ky dokument është përgatitur në kuadër të Projektit të USAID për gjithëpërfshirjen e Romëve i realizuar nga Instituti për hulumtime dhe analiza të politikave – Romalitiko me mbështetje të popullit amerikan përmes Agjencisë së SHBA për zhvillim ndërkombëtar (USAID). Mendimet e shprehura në këtë publikim i takojnë autorëve dhe nuk shprehim qëndrimet e Agjencisë së SHBA për zhvillim ndërkombëtar ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.*

*Ky dokument është pjesë e aktiviteteve të përcaktuara në të njëjtin të cilat janë të hartuara në pajtim me memorandumun për mirëkuptim (MM) të nënshkruar ndërmjet Këshillit të Evropës, Ministrisë së punës dhe politikës sociale dhe Komunës së Kërçovës në kuadër të realizimit të programit ROMACTED Faza II, iniciativë e përbashkët të Komisionit Evropian (DG NEAR) dhe Këshillit të Evropës, të realizuar në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, vitet 2021-2024. Pikëpamjet e ndara këtu nuk duhet të konsiderohet se janë mendim zyrtar i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës*